

## KONTRATË PËR SHIT-BLERJEN E KUOTAVE TË KAPITALIT

### Ndërmjet:

Z. Endri Karati, shtetas shqiptar lindur në Permet, më 07/01/1988 dhe me numër ID: I80107087F , në vijim **shitësi**;

dhe

Znj. Blerta Daja, shtetase shqiptare lindur në Kavaje , më 07/03/1990 dhe me numër ID: J05307128J, në vijim **blerësi**;

Duke qënë se:

- A. Shitësi është pronar i një kuote pjesmarrjeje të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) në kapital themeltar të shoqërisë Block 17 SHPK, shoqeri e së drejtës shqiptare, me seli në DURRES Lagjja nr.17, Zona Kadastrale 8513, Nr.5/350-N1, Vol, 37, me kapital themeltar 100.000 ( njëqind mijë) Lekë, e rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me kod identifikues tatimor NUIS Nr. M01329503P (**shoqëria**).
- B. Shitësi ka rënë dakord t'i shesë Blerësit dhe Blerësi është dakord të blejë nga Shitësi kuota me vlerë nominale të përgjithshme 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, që perfaqësojnë 50 %(pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë ( **Kuotat**), kundrejt cmimit dhe në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë.

### PËR SA MË SIPËR:

Në konsideratë të parashtrimeve të mësipërme, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

#### 1. Kalimi i kuotave

Me lidhjen e kësaj kontrate, Shitësi shet dhe i kalon Blerësit , dhe Blerësi blen kuotat e lira nga pengje, kufizime ose detyrime të çfardo lloji dhe natyre.



## **2. Deklaratë dhe garanci e Shitësit**

Shitësi deklaron se kuotat janë lirisht të transferueshme, duke qënë se ortakët e shoqërisë kanë hequr dorë nga ushtrimi i së drejtës së para blerjes, parashikuar në statut, sipas deklaratave të lëshuara prej tyre që i bashkëlidhen kësaj kontrate në aneksin A, dhe duke qënë se nuk parashikohen kufizime të tjera në statutin e shoqërisë.

## **3. Legjislacioni i zbatueshëm**

Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar.

## **4. Dispozita të përgjithshme**

- 4.1 Të gjitha shpenzimet dhe kostot që lidhen me këtë transaksion janë në ngarkim të blerësit.
- 4.2 Kjo kontratë nuk zëvendëson ose ndryshon në asnjë pjesë ose mënyrë marrëveshje të lidhura veçmas ndërmjetë palëve.
- 4.3 Palët marrin përsipër të nënshkruanë dhe dorzojnë cdo akt, kontratë, dokument ose deklaratë tjetër, që mund të jetë e nevojshme ose e përshtatshme për zbatimin e plotë dhe të saktë të kalimit të kuotave nga Shitësi te Blerësi.
- 4.4 Palët pranojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale sipas legjislacionit shqiptar, këto të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave vetëm për qëllime që lidhen me këtë kontratë, apo me formalitetet dhe efektet tativore që lidhen me të.
- 4.5 Kjo kontratë është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe.

Durrës, më 0103/2021

Shitësi

Endri Karati



Blerësi

Blerta Daja

